

FJALA E DEPUTETES MIRELA KUMBARO

E ENJTE 10 NËNTOR 2022

Sot dëgjuam shumë kolegë që u qanë, sepse nuk po flitet për buxhetin, ndërkohë që janë dëshmitarë të disa fjalimeve, ku fjala “urrejtje” dhe folja “urrej” u lakuan dhe u zgjedhuan në të gjitha kohët, mënyrat dhe vetat, por për të mos përfunduar me një analizë. Ju nuk keni program, nuk keni vizion, nuk keni argument për t’u përballur me ne. Po mirë, me çfarë e zëvendësoni? Me thirrje për heqje zvarrë dhe për dhunë fizike?! Të akuzosh për gjuhën dhe pastaj të kërcënosh me dhunë fizike, është hall i madh! Jo se është hera e parë, se e kemi parë se çfarë janë protestat që ju keni organizuar! Janë zjarr në sheshet publike, janë dëmtime të pronës publike, janë implikim i qytetarëve shqiptarë në thyerje, në përleshje, në zjarr. Përleshje për ju?! Zjarr për ju?! Zjarr Shqipërisë për ju?! Si mundet politika t’u kërkojë shqiptarëve t’i vënë zjarrin Shqipërisë? Sepse alternativa të tjera nuk keni! Cila qeveri i përballoi krizat me të cilat historia na ndëshkoi, na përballi, na sfidoi në këta 4 vjet, duke filluar me tërmetin, me pandeminë dhe tani me krizën botërore energjetike? Cila qeveri mbrojti, rindërtoi, po rindërton, bëri vaksinat? Cila qeveri? Është kjo qeveri që vazhdon të jetë këtu në mandatin e tretë të saj.

Në fakt, për t’iu kthyer përgjigje atyre që thanë se nuk po flasim për buxhetin, po i referohem sektorit të turizmit, duke iu dhënë kështu përgjigje edhe disa kolegëve që dje manipuluan me shifrat dhe me zërat.

Në fillim të këtij viti, kur e gjithë bota, por kryesisht Europa, u përball me fillimin e një konflikti në Ukrainë, që tashmë është kthyer në një rutinë të përditshme me pasojat që prodhoi në të gjithë Europën dhe pa dyshim edhe në Shqipëri, të gjithë menduan se turizmi do të merrte një goditje të rëndë, siç e mori në kohën e pandemisë, në fakt, sepse u anuluan në mënyrë masive rezervimet e bëra nga turistët ukrainas, rusë dhe bjellorusë. Mirëpo, sektori i turizmit tregoi se ishte shumë energjik, ishte fleksibël dhe reagoi në mënyrë të menjëhershme, duke iu përshtatur tregut pa humbur kohë. Jo vetëm e absorboi këtë mungesë të papritur, por 6,4 milionë turistë të huaj e vizituan Shqipërinë deri më 30 shtator, pa llogaritur këtu vizitorët mysafirë, që vijnë çdo vit nga Kosova përmes pikës së Morinës falë marrëveshjes dypalëshe që të mos regjistrohen për t’ua lehtësuar aksesin.

Të dashur kolegë, 6,4 milionë ishte shifra e vizitorëve gjatë vitit 2019, që është mbajtur si viti më i mirë turistik, pra kaq u regjistruan deri në shtator. Megjithatë, pavarësisht rritjes së çmimeve në nivel global, tregu turistik ka përformuar shumë mirë që nga shitjet deri në aktivitetet e hoteleve, bareve dhe

restoranteve, që u rritën në 6-mujorin e parë me 33,1%, dhe aktivitetit të agjencive të udhëtimit me 89,2%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ndërkohë, po t'u referohemi edhe të dhënave ndërkombëtare, prodhimi i brendshëm bruto është rritur prej të ardhurave nga investimet në sektorin e turizmit për vitin 2021 me 17,5%. Ky ka qenë kontributi i sektorit të turizmit sipas Këshillit Botëror të Udhëtimit dhe Turizmit të paraqitur në raportin e tyre të fundit.

Po marr vetëm një shembull, Vlorën, për të kuptuar këtë lloj energjie të sektorit. Gjatë sezonit veror në sektorin e turizmit në Vlorë numri i të punësuarve shkoi në 27 mijë, ndërsa u aktivizuan 1 mijë subjekte turistike, nga të cilat 280 ishin subjekte të reja të aktivizuara gjatë vitit 2022. Një mënyrë tjetër se si mund ta shikojmë sektorin është zbatimi i një pjese të projekteve infrastrukturore, përmirësimi i shërbimit, organizmi i koordinuar i sektorit, mbështetja e pandërprerë në nivel fiskal të bizneseve të vogla dhe të gjitha strukturave akomoduese me TVSH-në 6% dhe i agroturizmit me 5%. Mbrojtja e familjeve dhe biznesit të vogël ndaj çmimit të energjisë nga kjo qeveri solli, pa dyshim, përmirësim të ndjeshëm në disa komponentë të turizmit për 7-mujorin e parë, sepse një pjesë e mirë e bizneseve në sektorin e turizmit janë pikërisht biznese të vogla, çka solli dyfishim të kohës së qëndrimit të turistëve, rritje me 21% të shpenzimeve ditore mesatare prej tyre, rritje me 36% të nivelit të pëlqyeshmërisë së turistëve, rritje me 40% të nivelit të pastërtisë, sipas gjithë të dhënave të INSTAT-it, të cilit i referoheni edhe ju. Ndërkohë, investimet e kryera në infrastrukturë rrugore dhe aeroportuale...

Kam respekt për ju, zoti Bushati, por nuk kam aspak respekt kur më ndërprisni!

Investimet e kryera në infrastrukturën rrugore dhe aeroportuale, që nga rruga Kardhiq-Delvinë deri te Rruga e Arbrit në Dibër, pa dyshim, u shërbejnë banorëve, por kanë një frymëmarrje të re për turizmin. Madje, po të shikojmë sërish shifrat e INSTAT-it, ka një pëlqyeshmëri me 41% për Veriun e vendit. Këtu kam parasysh Rrugën e Arbrit në Dibër, rrugën Kardhiq-Delvinë, rrugën në Theth e me radhë.

Synimi për vitin 2023 është që të shkojmë për turizëm në të 12 muajt e vitit, sepse investimet në infrastrukturë janë investime me impakt të drejtpërdrejtë në turizëm. E para, shkojmë në thellësi të territorit dhe, e dyta, shtrijmë turizmin nga 3 muajt e verës në 8 muaj që jemi sot dhe në 12 muaj që duam ta bëjmë në vitin 2023.

Sot që flasim hotelet në Tiranë janë plot. Lezha ka qenë e vijon të jetë një model i turizmit detar dhe agroturistik. Sot të gjitha hotelet në Gjirokastër, në Korçë, në Përmet, në Pogradec janë plot dhe, nëse nuk rezervon për të kaluar fundjavat, nuk i gjen të lira. Kjo vlen edhe për ju, zoti Bushati, por do ta gjejmë me mik edhe për ju një akomodim në fundjavë.

Ofertat ekoturistike për shëtitje në mal apo në lumë janë, gjithashtu, oferta të reja që i shtohen tregut turistik gjatë gjithë viti, kjo, sigurisht, është favorizuar këtë vit edhe nga moti. Sot që flasim, kemi mbi 260 oferta agroturizmi në të gjithë Shqipërinë, që krijojnë, në fakt, ekonomi lokale, promovim të territorit, ruajtje të aktiviteteve turistike gjatë gjithë vitit. Pikërisht për këtë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit parashikon që me buxhetin e vitit 2023 të koordinojë një kalendar turistik aktiviteteve për të pasur ofertën turistike me trashëgimi kulturore jomateriale për të promovuar thesaret e vendit dhe për të pasur një kalendar turistik kombëtar dinjitoz, i cili na prezanton edhe në turizmin ndërkombëtar. Në fakt, përgatitja e sezonit veror ka filluar; pikërisht kjo është koha e aplikimeve për stacionet e plazheve të menaxhuara, proces të cilin do ta mbyllim brenda këtij viti, me qëllim që edhe sektori privat, edhe njësitë e qeverisjes vendore të jenë të përgatitura që në fillim të vitit për sezonin e ardhshëm.

Me buxhetin e vitit 2023 do të shtohet vija bregdetare, që gjatë sezonit të verës do të mirëmbahet dhe do të pastrohet nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit, duke përfshirë Sarandën, Himarën, Vlorën, Rrogozhinën, Kavajën dhe Durrësin, operacion që na rezultoi shumë i suksesshëm këtë vit që e mbyllëm në katër bashki.

Po kështu, do të vijojë mbështetja nga qeveria për planin e pastrimit kombëtar, duke e rritur këtë zë me 700 milionë lekë me transfertën e pakushtëzuar, prej së cilës do të përfitojnë këtë vit 30 bashki, ku edhe frekuenca turistike është më e madhe, duke filluar nga Shkodra, Lezha, Malësia e Madhe dhe deri në Sarandë.

Menaxhimi i integruar i mbetjeve

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka punuar në vitet 2021-2022 për përgatitjen e një projekti madhor me Bashkimin Europian prej 35 milionë eurosh me programin IPA për investimin e plotë të infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve në të gjithë qarkun e Kukësit dhe në qarkun e Gjirokastrës.

Ndërkohë, dua të shtoj se zonat e mbrojtura janë prioritet. Përveç projektit prej 8 milionë eurosh me Bashkimin Europian, me të cilët kemi përgatitur projektet, me investimin e buxhetit të qeverisë dhe të ministrisë do të investohen 500 milionë euro për të rikualifikuar infrastrukturën turistike të “Eko-Park Ulza”, sot park natyror, sepse zonat e mbrojtura janë mjedis, por zonat e mbrojtura janë edhe turizëm. Jo më kot ne kemi numëruar 4 milionë vizitorë në zonat e mbrojtura këtë vit, prandaj, siç bëmë investime vitin e kaluar në Syrin e Kaltër, do të vazhdojmë të bëjmë edhe në “Eko-Park Ulza”.

Unë kam edhe shifra të tjera, dhe jam shumë e gatshme t'ua japë sërish me shkrim kolegëve, nëse do të jenë të interesuar, për të mos shtënë këtu me plumba në ajër, me shifra të pambështetura, njëlloj si thirrjet për zvarritje.

Ne mund të kemi divergjenca plot; ne mund të kemi kritika për punën e njëri-tjetrit, është shumë normale, prandaj jemi në politikë, prandaj jemi në pushtet, prandaj jemi në pozitë, por ne mund të biem dakord edhe kur nuk biem dakord, por në këtë kohë krize të shkaktuar nga lufta e Putinit mbi Europën kemi treguar se si i përballojmë krizat. Mbase ju kanë mbetur ende rubla pa shpenzuar dhe duhet të vazhdoni të financoni me to thirrjet për dhunë! Si mund të kemi politikanë që fërkojnë barkun, duke folur në të gjitha gjuhët e mundshme me fjalë të zeza për të nxirë Shqipërisë?! Si mund të shahet kombi?! Si mund të fyhen shqiptarët në punën e tyre të ndershme në sektorin e turizmit?! Madje, sot e bëtë sërish këtë gjë.

Si ka mundësi që të keni një dëshirë, gati perverse, për të nxirë turizmin, për të nxirë sezonin turistik, për të nxirë shërbimin turistik, për të nxirë investimet që bën sektori publik dhe privat në turizëm?! E vetmja gjë që mund të them në këtë rast është: Zoti ju ndjeftë, por shqiptarët, nuk ju kanë ndjerë, përkundrazi ju kanë ndëshkuar me tri mandate në opozitë. Faleminderit!